

KREMTOHET NË BOSTON NGRITJA E FLAMURIT SHQIPTAR

Nga Rozi Theohari

Festimi i 98-vjetorit të Ditës së Pavarësisë filloi me celebrimin e darkës në “Renaissance Éaterfront hotel Boston” më 27 nëntor 2010, ku morën pjesë bostonianë të vjetër e të rinj, miq e të ftuar si dhe shqiptaro-amerikanë nga të gjitha trojet etnike. Të ftuar ishin zonja Arta Rama, konsullja e Kosovës, Dr. Anna Kohen, presidente e organizatës “Motrat Qiriazit” në Nju-Jork, zonja dhe zoti Van Christo, përfaqësues të shoqatës “Kosova” e të tjerë. Shoqata shqiptaro-amerikane MASBESA, e cila organizoi mbrëmjen, nderoi me “Dekoratën e Mirënjohjes” Dr. Anna Kohen, për kontributin në ndihmë të shqiptarëve në nevojë, për ndihmën e madhe e të pakursyer që ajo dhe organizata që drejton i kanë dhënë diasporës së Massachusettsit, sidomos ndihmës për shëndetin e fëmijëve kosovarë. Gjithashtu shoqata “Kosova” e nderoi Dr. Anna Kohen me certifikatën e “Mirënjohjes” për kujdesin që tregoi rreth shëndetit të fëmijëve ardhur nga Kosova.

Në mbrëmje përshëndeti Albana Orgocka, anëtare e bordit drejtues të shoqatës BESA, e cila prezantoi Dr. Anna Kohen. Mes duartrokitjesh Dr. Kohen, midis të tjerash tha : “E ndiej vehten thellësisht të respektuar që jam mes jush, e nderuar me Dekoratën e Mirënjohjes, sonte, në përkujtimin e ditës së pavarësisë dhe ngritjes së flamurit në qytetin tim të lindjes, në Vlorë”. Më tej ajo përmendi se Bostoni ka qenë dhe mbetet një qendër aktive, e rëndësishme e patriotizmit dhe e lëvizjes shqiptare. Për këtë ai meriton të kujtohet e të nderohet, perfundoi ajo. Me “Dekoratën e Mirënjohjes” u nderua gjithashtu artisti i shquar Xhoni Athanas me rastin e 85-vjetorit të lindjes si dhe në shenjë respekti për pasionin, përkushtimin dhe kontributin në mbajtjen gjallë të këngës shqiptare në Massachusetts. Gjatë mbrëmjes, poetja Vojsava Nelo, ardhur nga Shqipëria, përshëndeti dhe recitoi disa poezi nga libri i saj botuar kohët e fundit. Mbrëmjen e përshëndetën edhe miq të tjerë, të ftuar nga trojet etnike. Me këtë rast të pranishmit ndoqën edhe një ekspozitë fotografike të Roland Tashos, e titulluar “Unë flas shqip”.

Grupi i valleve të Bostonit “Bashkimi” e hapi mbrëmjen e dëfrimit, pasuar nga këngëtarët Eli Fara, Përparim Mefaj dhe grupi Kastrioti. Artisti shqiptar Xhoni Athanas këndoi disa këngë korçare bashkë me Eli Farën si dhe me gjithë pjesëmarrësit në sallë, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe emocionuese. Këngët, vallet e përshëndetjet vazhduan deri natën vonë.

Ditën e diel, më 28 nëntor, këngët e vallet u zhvendosën në sheshin para bashkisë së Bostonit, ku dhjetëra shqiptaro-amerikanë, burra e gra, pleq e fëmijë mbushën sheshin një orë para manifestimit. Shumëkush kishte sjellë nga shtëpia flamurin shqiptar dhe e valëviste në ajrin e ftohtë të nëntorit.

Është kuptimplotë që festën e flamurit tonë shqiptar e kemi pranë festës kombëtare të amerikanëve, ditës së thanksgiving(falënderimit). Kështu, gjatë festimit të Ditës së Flamurit ne, shqiptaro-amerikanët në të njëjtën kohë i japim falënderime Amerikës, e cila i është gjendur prane popullit shqiptar si për pavarësinë e Shqipërisë, ashtu dhe për pavarësinë e Kosovës. Ne falënderojmë bashkinë e Bostonit, e cila lejon dhe feston tok me ne ngritjen e flamurit shqiptar dhe atij kosovar në qendër të Bostonit.

Ceremonia e ngritjes së flamurit filloi në orën 12, me interpretimin e himnit të Amerikës dhe atij të Shqipërisë, dy himne tashmë të njohura, të kënduara e të nderuara nga shqiptaro-amerikanët. Fjalën përshëndetëse e mbajti Ada Kokoshi, sekretare e Masbesës. Në emër të Masbesës ajo uroi të pranishmit : “Gëzuar festën e Pavarësisë së Shqipërisë!” ...”Në këtë ditë,- tha ajo,- ne kujtojmë plot respekt dhe krenari dy ngjarje historike: atë të pavarësisë dhe atë të çlirimit të Shqipërisë nga Nazi-fashistët.” Ajo theksoi se Bostoni ka qenë dhe është një nga vatrat e komunitetit shqiptar që prej viteve të hershme të shekullit të 20-të. I madhi Noli, Konica dhe atdhetarë të tjerë shqiptarë nuk i ndërprejnë përpjekjet e tyre për pavarësinë e Shqipërisë. Dita e 28 nëntorit jep mundësinë që ne të mblidhemi e të festojmë së bashku unitetin tonë, me shpresa për një të ardhme më të mirë të komunitetit shqiptar.

Në këtë ditë kujtojmë me respekt edhe mijëra shqiptaro-amerikanë të 100 viteve të komunitetit shqiptar, të cilët kanë luftuar pa u ndalur për çështjen e kombit, duke zhvilluar aktivitete në Boston, kryeqytetin e emigrantëve shqiptarë, mitingje, festivale, parada e manifestime ku, flamuri i kuq me shkabën e zezë është valëvitur mbi kokat e tyre krahas flamurit amerikan.

Në kremtimin e kësaj dite festive, vlen të përmendet aktiviteti dhe puna e palodhur e shoqatës MASBESA, e cila ka synim ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, promovimin e vlerave, identitetit kombëtar dhe mbrojtjen e interesave të komunitetit. MASBESA i mbledhi shqiptaro-amerikanët më 28 nëntor në sheshin e Bostonit për ngritjen e flamurit. Këtë ditë, guvernatori i Massachusettsit, Deval Patrick e ka shënuar si “Dita e Shqiptarëve”.

Manifestimin e përshëndeti Dr. Anna Kohen, e cila , para se të fliste, hapi mbi podium një flamur shqiptar, duke u përgëzuar dhe duartrokitur nga pjesëmarrësit. Dr. Kohen gjatë përshëndetjes shprehu gëzimin që ndodhej në Boston për të festuar bashkë me bostonianët këtë ditë të madhe dhe uroi që shqiptarët kurdoherë të jenë të bashkuar. Më tej përshëndeti zoti Stefan Koçi, konsulli i nderit i Bostonit, ndërsa Mark Kosmo dhe Nerajda Vlladesi, bashkëkryetarë të shoqatës BESA, lexuan “The Proclamation of the State” (Proklamata e shtetit të Massachusettsit).

Mes tingujve të himnit të flamurit, duartrokitjeve dhe gëzimit ngazëllyes flamuri shqiptar u ngrit në shtizë krahas atij amerikan, nga studentja shqiptare Fjorela Dragoti, e cila është shpallur si valedictorian e shkollës së saj të mesme “Monument High School”, për vitin 2010.

Më tej grupi i valleve “Bashkimi”, pasuar nga të pranishmit e gjallëruan sheshin e bashkisë me valle e muzikë folklorike shqiptare nga të gjitha trojet etnike. Grupi polifonik i Bostonit i dha fund festës. Shqiptaro-amerikanët, duke ecur së toku në një paradë përmes Boston Commons dhe Boston Public Garden, qëndruan tek restoranti shqiptar “Vlora” për një pasdite kokteil me rastin e festës së pavarësisë.

(Fotomontazhi nga Kostandin Mosko)